



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

QENDRA NDËRINSTITUCIONALE E
RRJETIT AKADEMIK SHQIPTAR

Nr. ~~145~~ Prot. Tiranë, më 13.10.2025

Nr. 145 Prot. Tiranë, më 04.11.2025

URDHËR I PËRBASHKËT

Nr. 141, Datë 13/10 /2025

**PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN E PËRBASHKËT NR. 157, DATË 03.06.2025,
“PËR MIRATIMIN E KALENDARIT PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË
REGJISTRIMIT NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK
2025 – 2026”**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit nr. 436, datë 03.06.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim”, i ndryshuar dhe të udhëzimit nr.12, datë 30.06.2023, “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë” i ndryshuar,

URDHËROJ

1. Në kalendarin e miratuar sipas urdhrit të përbashkët nr.157, datë 03.06.2025, “Për miratimin e kalendarit “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2025-2026”, në shtojcën nr.1, në kolonën e referencave në pikën 5 dhe 6, Kreu VII, si dhe pikën 4 dhe 5, Kreu IX i udhëzimit nr.12, datë 30.06.2023 i ndryshuar, bëhen ndryshimet sa më poshtë:

SHTOJCA NR. 1

Periudha/Datat		
Kreu VII		
PRANIMET NË ÇIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE “MASTER PROFESIONAL” DHE “MASTER I SHKENCAVE/MASTER I ARTEVE”		
Nr.	Referenca në Udhëzim dhe afatet e përfundimit dhe datat e realizimit	
Kreu VII		
	Ishte	Bëhet
1	Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues të zhvillohet pranë sekretarive mësimore përkatëse të IAL-ve deri më 27 tetor 2025 . Kreu VII, pika 5	Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues të zhvillohet pranë sekretarive mësimore përkatëse të IAL-ve deri më 7 nëntor 2025 . Kreu VII, pika 5
2	IAL-ja shpall në vende të dukshme dhe publikon në faqen e saj elektronike zyrtare (web), listën emërore të kandidatëve të regjistruar brenda datës 31 tetor 2025 . Kreu VII, pika 6	IAL-ja shpall në vende të dukshme dhe publikon në faqen e saj elektronike zyrtare (web), listën emërore të kandidatëve të regjistruar brenda datës 11 nëntor 2025 . Kreu VII, pika 6
Kreu IX		
PRANIMET NË ÇIKLIN E TRETË TË STUDIMEVE “MASTER EKZEKUTIV”		
1	Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues të zhvillohet pranë sekretarive mësimore përkatëse të IAL-ve përkatësisht deri më 27 tetor 2025 . Kreu IX, pika 4	Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues të zhvillohet pranë sekretarive mësimore përkatëse të IAL-ve përkatësisht deri më 7 nëntor 2025 . Kreu IX, pika 4
2	IAL-ja shpall në vende të dukshme dhe publikon në faqen e saj elektronike zyrtare (web), listën emërore të kandidatëve të regjistruar brenda datës 30 tetor 2025 . Kreu IX, pika 5	IAL-ja shpall në vende të dukshme dhe publikon në faqen e saj elektronike zyrtare (web), listën emërore të kandidatëve të regjistruar brenda datës 11 nëntor 2025 . Kreu IX, pika 5


2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, Drejtoritë Rajonale dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Për Qendrën e Shërbimeve Arsimore

Drejtore i Përgjithshëm

Znj.Aida MYRTO



Për Qendrën Ndërinstitucionale

të Rrjetit Akademik Shqiptar

Drejtore i Përgjithshëm

Z. Arjan XHELAJ

